



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 20.2.2012, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MBPZHR me ministrin dhe MMPH, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 14.02.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbeturina,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime. Komisioni u pajtua që të shqyrtohet raporti i kontaminimit nga projekti EULUP.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.2.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.2.2012.

3. Shqyrtimi i Raportit nga EULUP

Nait Hasani përshëndeti dhe falënderoi për pjesëmarrjen e ministrit të bujqësisë të cilit fillimisht i rikujtoi rekomandimet rreth monitorimit të ligjit për tokën bujqësore nga ky komision, kur është konstatuar ndotja e tokës bujqësore në disa rajone industriale të Kosovës, mirëpo asses i “helmim i tokës bujqësore” ashtu si është konstatuar me rastin e publikimit të raportit nga projekti EULUP, ai përsëriti konstatimin e tij të mëhershëm se ky raport paraqet një bombardim dhe terror të përpjekjeve tona në sektorin e bujqësisë pa u bërë një analizë e duhur. Para se të jap fjalën ministrit, ai njoftoi zyrtarët prezentë nga dy ministrinë me kërkesën e komisionit për krijimin e një komisioni të përbashkët (MMPH, MBPZHR, IKSHPK dhe Fakulteti i Bujqësisë) që do të merret me analizat e raportit, për të kthyer besimin e luhatur tek fermerët. Ai gjithashtu njoftoi me të dhënat zyrtare nga doganat e Kosovës me rastin e eksportit të patates nga Kosova për Malin e Zi më 30.1.2012 ku konstatohet se prodhimet tona nuk përmbajnë helmime apo me ndonjë ndotje që kishin me qenë brengosëse, bile ato janë në nivelin më të ulët në krahasim me vendet e rajonit.

Blerand Stavileci falënderoi dhe theksoi rëndësinë e diskutimeve të përbashkëta lidhur me këtë raport. Ai tha se MB vazhdimisht ka qenë “bashkudhëtar i këtij raporti”, mirëpo ajo ka deshtë të veprimi me maturi ngase është prezantuar në praninë e tri ministrive, dhe kemi të bëjmë me veprime autoriale si dhe ky raport nuk është përfundimtar. Ai shtoi se ky raport nuk është i KE-së por i një kompanie të KE-së. Ai konstatoi gjendjen e kundërt nga raporti që prezanton, ngase në Kosovë tanimë ka filluar dukshëm të shtohet prodhimi i produkteve bujqësore. Ai tha se në MB vazhdimisht arrijnë kërkesat për demantimin e raportit në fjalë, mirëpo edhe ato përmbajnë gabime (nga laboratorit Kosovare të cilat janë të licencuar me certifikatën GLOBAL GAP), rreth sasive të lejuara apo jo të lejuara të shkarkimeve të ndryshme të dëmshme, ndaj konstatoi se nuk ka nevojë për politizim sepse kemi të bëjmë me çështje profesionale dhe shumë të ndjeshme : ushqimore. Ai gjithashtu potencoi punën e shkëlqyeshme të këtij komisionit kur ka monitoruar ligjin për tokën bujqësore. Me rastin e kundërshtimit të raportit në fjalë, ministri tha se do të përcjellët edhe mesazhi i MB se prodhimet tona janë të sigurta dhe të shëndosha dhe në binarin e duhur, si dhe me veprimet e tanishme të ministrisë kjo çështje ngritet në nivelin e debatit shkencor me çka do të përmbillet ky kapitull në mënyrën më të mirë për Kosovën. Ata që shfrytëzojnë këtë situatë për të dëmtuar Kosovën, do të janë dëmtues të pasuksesshëm, përfundoi. **Nait Hasani** falënderoi për sqarime fillestare dhe hapi diskutimin. **Afërdita Berisha** pyeti pse nuk është verifikuar ky raport nga MB para se të publikohej, ngase shqetësuese është të konstatohen kontaminimet pa treguar vendin e tyre dhe sasinë e tokës së ndotur si dhe shkallën e ndotjes (helmimit). **Ministri** tha se pikërisht për këtë arsye kanë dashur të mbajnë të fshehur derisa të verifikohen faktet e dhëna deri më 2 shkurt kur është publikuar, ndaj për këto brenga ai shfaqti drojën se do të shtyejnë në një teori të konspiracionit. Edhe po të miren të sakta se 123 mostrat janë të vërteta, , analizat tregojnë shumë gjëra kundërtëse për sasinë e metaleve, për një lajm të helmuar, ngase toka mundet të ndotet por jo edhe të helmohet. Ai apeloi që mos të tentohet në këtë takim të thuhet fjala e fundit lidhur me këtë çështje.

Liburn Aliu tha se kemi të bëjmë me një çështje shumë serioze ngase në njërin anë të gjithë e dinë se ndotja është prezente në Kosovë dhe lehtë mund të ndërlihet ky dukuri me zingjirin ushqimor, ndaj ne duhet të angazhohemi rreth masave që duhet të ndërmerren, duke sanuar tokën e ndotur, duke ja rrit buxhetin MMPH-së dhe duke mos menduar në poena politike si ndodhi apo pse ndodhi. Interesante është edhe fakti se, vazhdoi, sapo filloi MBPZHR fushatën për prodhimet vendore, doli ky raport dhe e goditi mu këtë aktivitet të MB. Me rëndësi është si do të trajtohet në të ardhmen mjedisi, ngase toka nuk dëmtohet vetëm nga ndotja por edhe ndërtimet e egra etj, përfundoi. **Salih Morina** shfaqti shqetësimin si vijon : pse nuk e ka diskutue këtë çështje Qeveria, pse KE (komisioni evropian) nuk e ka demantuar kompanin që rrjedhë nga ai, pse KE nuk ka lajmëruar as MB-në e as Komisionin parlamentar (Kuvendin). Ai kërkoi nga ministri të shpejtoj hapat ministria sa i përket demantimeve që duhet të bëhen, ngase asgjë momentalisht nuk është më prioritarë. Ai tregoi se komisioni nuk është marr gjatë monitorimit me përqindjet e ndotjes së

tokës bujqësore ngase ministria duhet ti konstatoi ato. **Sevdije Lama** pyeti pse janë marr mostrat e metaleve në disa vende por jo edhe në disa vende tjera dhe pse vetëm metalet, ndaj pyeti a duhet MB të hartoi një ligj për trajtimin e këtyre mbetjeve. **Nijazi Idrizi** u pajtua me konstatimin e kryetarit se kemi të bëjmë me një raport bombastik për sektorin bujqësor por që ka goditur edhe marketingun që jemi angazhuar aq shumë për te. Zërat aktual, vazhdoi, tregojnë se fermerët në Kosovë do ti drejtohen Gjykatës duke paditur EULUP dhe MB (ministri reagoi : pse MB-në, Nijazi Idrizi tha sepse ata dinë se MB ka pasur në atë projekt përfaqësuesin). Ai tha se raporti është tendencioz për të shkaktuar kaos në bujqësinë Kosovare. Ai pyeti për mostra si janë përzgjedhur, sipas rastit apo sipas zgjedhjes për të konstatuar në fund se duhet të dominoi njohuria për fakte. **Ministri** përsëriti reagimin e mëhershëm duke shtuar se hapi i ardhshëm i MB do të jetë projekti për planifikim rural. Lidhur me padi që thuhet se do të ngritet ndaj MB, ai shtoi se ministria kërkon vetëm realitetin dhe asgjë tjetër dhe çdo gjë mbetet e hapur. **Nijazi Idrizi** reagoi dhe tha se askush nuk thotë se MB nuk ka reagua, por në fakt dikush është dashur të jetë më aktiv për të orijentuar projektin aty ku duhet (anëtari i MB që është aty në projekt), për të mos shkaktuar dëme bujqësisë sonë, ngase si tha ai “a nuk është gjynah që fermerët e Rahovecit të paralajmërohen ta lënë bujqësinë dhe të orijentohen tjetërkah për shkak të konstatimeve jo të sakta të raportit”. **Ministri** premtoi se ky raport nuk është përfundimtar dhe nuk ka pasur mundësi të reagohej më heret se më 2 shkurt, kur eksperti përkatës ka prezantuar atë. Ai premtoi se çdo gjë do të zërthehet deri në fund. **Kapllan Halimi-sekretar** shtoi se versionin e ekspertit ka dalur më 2 shkurt 2012 dhe nuk është final dmth është një draft i publikuar në media. **Sylejman Berisha** nga Bordi mjedisor tha se kemi të bëjmë me një lojë politike dhe nuk ka vend për preokupime apo brengosje, duhet të pritet versioni final ngase toka nuk ka helmim por vetëm ndotje dhe ajo në Kosovë është më e ulëta në rajon. **Blerand Stavileci** lidhur me ligjin e propozuar nga S. Lama tha se MB mbështet ligjin për mjedis rreth shpërndarjes së ndotësve dhe materjeve inorganike, dhe siguroi se ekspertiza do të konstatoi fjalën përfundimtare. **Afërdita Berisha** shtoi se hulumtimi shkencor duhet të vërtetoi dhe analizoi si janë ndotur, kah kanë ardhur materjet ndotëse etj.

Nait Hasani përmbylli këtë çështje me rekomandimin e komisionit për krijimin e një ekipi të përbashkët të cekur më lart, të cilët do të japin fjalën përfundimtare, ndërkaq ministrin dhe zyrtarët tjerë nga MMPH dhe MBPZHR falënderoi për kontributin e dhënë.

4. Projektligji për Mbeturina

Rreth shqyrtimit të projektligjit në fjalë **Nait Hasani** dhe anëtarët tjerë konstatuan se nuk prezanton eksperti përkatës, pa të cilin u konstatua se nuk mund të vazhdoi puna rreth shqyrtimit të vërejtjeve. **Enver Tahiri** tha se vërejtjet e ekspertit nuk lëvizin në esencë nga qëndrimet e MMPH, por vetëm kemi të bëjmë me ndryshime teknike, megjithatë komisioni caktoi një mbledhje për javën tjetër sipas marrëveshjes me ekspertin i cili duhet të pyetet kur i konvenon takimi.

5. Të ndryshme

Në pikën e rezervuar për çështje tjera, **Nait Hasani** hapi diskutimin rreth vizitës së komisionit në Austri ku janë sugjeruar 5 deputet me financimin nga TAIEX dhe MB, si dhe një nga stafi me financim nga Kuvendi. **Liburn Aliu** kundërshtoi mënyrën e caktimit të delegacionit pa u hapur debati në Komision dhe shfaqti dyshimin se edhe pyjet do të privatizohen sikurse NP-të që i kemi të paprivatizuara, gjithashtu përsëriti konstatimin e tij se Bullgaria është më e favorshme për të vizituar rreth pyjeve sesa Austria mirëpo **kryetari** sa i përket caktimit të delegacionit tha se kjo është bërë në vikendin e kaluar për shkak të urgjencës nga donatorët e vizitës, si dhe kjo gjë ende nuk është përfundimtare. Pas disa sqarimeve nga kryetari dhe anëtarëve prezent, komisioni konstatoi se çdo gjë rreth caktimit të vendit të vizitës, delegacionit etj në të ardhmen duhet të bëhet me MIRËKUPTIM dhe MARRËVESHJE.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani